



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 10**

**Datë: 30. 01. 2021. Ora: 17:00**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

**Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.**

**Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Artan Asllani, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.**

**SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.**

**ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.**

**Përkthyes: Argjina Misini**

**Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.**

---

### **RENDI I DITËS**

- 1.** Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
- 2.** Aktivitetet e SKQZ-së
- 3.** Aktivitetet e ZRPPC-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të ZRPPC lidhur me Aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës për certifikimin e kandidatëve të subjekteve politike

- 4.** Raport i Këshillave të KQZ-së:

- Këshilli për Buxhet dhe Financa:

- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor financiar i KQZ-se për vitin 2020

-Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të auditmit të brendshëm për vitin 2020;

- Shqyrtimi dhe miratimi kërkesës për zyrtarët e KQZ-së për kompensimin e stafit për shkak të rrezikshmërisë me pandeminë COVID-19, për procesin zgjedhor 2021.

5.Këshilli për Informim Publik

- Informatë për aktivitetet e Informimit Publik

6.Të ndryshme.

---

### **1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:**

**Valdete Daka:** Atëherë përshëndetje të gjithëve. E hapi mbledhjen e 10-të të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. A ka dikush vërejtje në rend të ditës? Nëse jo. Kush është për këtë rend dite? Miratohet rendi i ditës...

### **2.Aktivitetet e SKQZ-së**

**Burim Ahmetaj:** Faleminderit kryetare. Të nderuar anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Sekretariati është në procesin e vlerësimit të zotësisë juridike të votuesve, të cilët kanë aplikuar për tu regjistruar si votues jashtë vendi. Aktualisht të dhënat janë nga raportimi I orës 15:00 të ditës së sotme dhe të dhënat janë si në vijim. Nga baza aktuale e të dhënave, kemi gjithsej 178.26 aplikues. Vlerësimi I zotësisë juridike është bërë për 138.657 apikues, që shprehur në përqindje është 77.88% të aplikacioneve të cilat janë të regjistruara në bazën e të dhënave. Pra nga 138.357 aplikacione të aprovuara janë 127.639 aplikacione ndërsa në pritje janë 10.964 aplikacione. Aktualisht procesi I vlerësimit të zotësisë juridike është në proces e sipër, dhe aplikacionet të cilat kanë mbetur të pa procesuara dhe kemi planifikuar që gjatë ditës së sotme të kryhet ky operacion, janë 39.369 aplikacione, pra të gjitha këto janë aplikacione të mbetura për të cilat do të bëhet vlerësimi I zotësisë juridike. Pra këto janë ato të dhënat sa I përket operacionit apo shërbimit votues, sa I përket vlerësimit të zotësisë jurike ndërsa nga qendra e thirrjeve kemi gjithsej 48.712 thirrje të realizuara deri më tani. Pra nga këto shifra 40.131 votues janë të

konfirmuara, prej tyre 115 aplikues kanë deklaruar që nuk janë aplikues të cilët figurojnë në data bazën dhe për të cilët është aplikimi për tu regjistruar si votues jashtë vendi. 8466 persona nuk e kanë hapur telefonin, mirëpo jemi në proces e sipër, dhe do ti kthehemi përsëri të bëjmë thirrje të mëtutjeshme dhe në përqindje I bie nga thirrjet e realizuara deri më tani janë 82.38%.

Më lejoni të ju informojë se, kemi shtuar edhe linjat telefonike dhe deri më tani I kemi 33 linja telefonike nga të cilat do të bëjmë thirrje, po sa të përfundojë procesi I vlerësimit të zotësisë juridike, proces I cili do të ndodh sot. Nesër do të kemi procesin e kontrollimit e të gjithë data bazës që do të thotë do të kontrollohen të gjithë votuesit që kanë fituar zotësinë juridike, votuesit të konfirmuar të pa konfirmuar me qëllim që të kemi data bazën e verifikuar dhe të saktë. Pra të gjitha këto të dhënat të cilat janë në raport këtu para jush, janë të dhëna preliminare dhe nesër po sa të kontrollohet e gjithë data baza atëherë do ti kemi edhe të dhënat finale sa I përket shërbimit apo votimit jashtë vendi. Pra në pika të shkurta këto janë shërbimet apo aktivitetet e sekretariatit, ndërsa nga nesër e tutje mbetet vetëm edhe operacioni I thirrjeve me qëllim që të kompletohet votimi jashtë vendit. Faleminderit.

**Valdete Daka:** Faleminderit Burim. A ka dikush pyetje për Burimin? Nëse jo. Vazhdojmë me aktivitetet ZRPP-së. Urdhëro Yll.

### **3.Aktivitetet e ZRPPC-së:**

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të ZRPPC lidhur me Aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës për certifikimin e kandidatëve të subjekteve politike

**Yll Belushkaj:** E nderuar kryetare , të nderuar anëtar. Faleminderit shumë për mundësin. Para jush e kemi paraqit një përmbledhje të asaj që është zhvilluar ditëve së fundit në lidhje me certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre duke I përfshirë vendimet e PZAP-it dhe vendimet e fundit nga gjykata supreme e Kosovës. Disa nga kandidatët që fillimisht nuk janë certifikuar tashmë me vendim direkt të këtyre institucioneve, janë certifikuar po ashtu e kemi edhe një subjekt politik NISMA, e cila është PZAP-i e ka certifikua për ne ndërsa numri i disa kandidatëve të cilët fillimisht nuk janë certifikua nga PZAP-i I ka kthye gjykata supreme në listë, duke I përjashtuar disa nga ta. Nuk e di a do të shkojmë vendim mbas vendimi sepse e kanë bërë si një përmbledhje për ju. Te NISMA, PZAP-i e ka ndryshua vendimin e KQZ-së për ta certifikua NISMËN e cila fillimisht nuk ka qenë e certifikime. Ndërsa për kandidatët pastaj disa nuk janë certifikua ndërsa I kemi edhe 3 të cilët janë certifikua direkt. Me vendimin numër 4 - 2021 PZAP-I e ndryshon vendimin e KQZ-së 245 - 2021 duket certifikuar listën e kandidatëve të partisë demokratike të

ashkalive të Kosovës, PDAK përveç një kandidati të cilën për shkak të korrektësisë, për shkak që nuk është certifikuar nuk do e përmendja, por e ka pas numrin 43 nga lista prej 44 kandidatëve.

Me vendimin numër 5 të PZAP-it, është ndryshua vendimi i KQZ-së 241-221 duke certifikuar listën e kandidatëve të PAI-së , përveç kandidatëve me numër 1, numër 11, numër 13 dhe numër 25 nga lista prej 44 kandidatësh. Vendimi numër 14 e ndryshon vendimin e KQZ-së numër 225/2021 duke de certifikuar kandidatin e subjektit politik Nova demokratska stranka, që ka pas numër 12 në listën e kandidatëve të cilët është certifikuar nga KQZ. Vendimi numër 15, 2021 i PZAP-së ia ndryshon vendimin e KQZ-së 240/2021 duke certifikuar listën e kandidatëve të subjektit politik AAK përveç kandidatëve me numër 2, numër 20, numër 74 dhe numër 70. Vendimi numër 16 i PZAP-it e ndryshon vendimin e KQZ-së me numër 242/2021 duke certifikuar subjektin politik NISMA dhe listën e kandidatëve të subjektit politik NISMA përveç kandidatëve me numër 10, me numër 17, me numër 21, 27, 38, 49, 52, 54, 74, 100 dhe 104 nga lista prej 110 kandidatësh. Vendimi me numër 17/2021 e ndryshon vendimin e KQZ-së , numër 244/2021 duke certifikuar listën e kandidatëve të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje , përveç kandidatëve me numër 1, 6, 11, 31 dhe 59. Vendimet e Gjykatës Supreme të djeshme, vendimi AA2/2021 e vërteton vendimin e PZAP-it 5/21 në lidhje me vendimin e KQZ-së 241/2021 për subjektin politik PAJ. Vendimi 3, AA3/2021 e ndryshon vendimin e PZAP-it, 15/2021 në lidhje me vendimin e KQZ-së 240/2021 duke përfshir listën e kandidatëve të certifikuar të subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK dhe kandidatin me numër 2. Për arsye të llogaritjes së pa saktë të periudhës 3 vjeçare.

Koha kur është marr vendimi i formës së prerë për kryerjen e veprës penale duke zhvendosur datën llogaritëse duke saktësua në të vërtet nga 6 janar që është data e shpalljes e 14 shkurtit, data e mbajtjes së zgjedhjeve. Vendimi numër AA4/2021 i cili ndryshon vendimin e PZAP-it 17/2021 në lidhje me vendimin e KQZ-së 244/2021 duke përfshirë listën e kandidatëve të certifikuar të subjektit Lëvizja Vetëvendosje edhe kandidatët me numër 11 dhe 59. Pika e katërt, vendimi numër AA5/2021 i cili e vërteton vendimin e PZAP-it numër 16 në lidhje me vendimin e KQZ-së 240/2021 për subjektin NISMA Social Demokrate. d.m.th nuk ka pas ndryshim. E kemi vendimin 6 i cili e vërteton vendimin e PZAP-it për subjektin politik Demokratska stranka, që ka decertifikuar kandidatin numër 12 nga lista prej 43 kandidatësh të LDS-së. Sot më datën 30 janar Zyra e presidentes së partive politike dhe certifikim ka kontaktuar partitë politike të cilat kanë pas rastet të justifikimit të plotë të listës apo janë de certifikuar kandidatët edhe është në afat deri në orën 16-të për tu riradhitur listat e kandidatëve, apo për të konfirmuar radhitjen e kandidatëve në listë ashtu siç është dorëzuar më herët. Njoftimi ka përmbajtur edhe shënimin, në rast të listave të kandidatëve subjekteve politike me minus kandidatë ku ka numër rendor, por mungojnë emrat e

kandidatëve ato hapësira në broshurat e kandidatëve dhe në formularin e rezultateve, kandidatët do ti hijezohen, shënohen për të evituar vendosjen gabim të votave të kandidatëve. Pastaj në orën 16:00 pas këtij njoftimi kemi pranuar një njoftim nga 4 subjekte politike të cilat janë deklaruar që do t'mbajnë listat e kandidatëve ashtu siç kanë qenë si në vijim LVV, NISMA, PDAK dhe AAK. Një subjekt politik ka dërguar një listë të riradhitur pa E, dhe një subjekt politik nuk ka kthyer fare përgjigje, NDS-ja. Bazuar në vendimin e gjykatës supreme me numër AA3/2021 dhe AA4/2021 ku saktësohet mënyra e llogaritjes së periudhës 3 vjeçare, për momentin kur vendimi për vepër penale ka hyr në fuqi në lidhje, që e zhvendos datën nga ajo e shpalljes së zgjedhjeve tek data e mbajtjes së zgjedhjeve atëherë zyra rekomandon edhe certifikimin e 2 kandidatëve të pa certifikuar të PAI-t. Vendimi i formës së prerë, hynë në këtë periudhën para 3 vjet, llogariten para ditës së zgjedhjeve. Po ashtu zyra rekomandon aprovimin e mbetjes së radhitjes së origjinaleve të listave të kandidatëve ashtu siç janë deklaruar subjekteve politike gjegjëse, ndërsa në një rast PAI e riradhitur. Aty ku ka numra rendor që mungojnë emrat e kandidatëve ato hapësirat, në broshurat e kandidatëve dhe në formularin e rezultateve të kandidatëve të hijezohen, s'hijezohen për të evituar vendosjen gabim të votave të kandidatëve.

**Valdete Daka:** Faleminderit. A ka dikush pyetje? Po urdhëro.

**Arianit Elshani:** Faleminderit shume kryetare. E para jemi në një mbledhje ku kemi vendime edhe të gjykatës supreme edhe të PZAP-it lidhur me diskutimet që kanë ndodhur në mbledhjen e kaluar, kur kemi pasur para vetës rekomandimin që realisht del të jetë jo ligjor, si i tillë që ka qenë para 1 jave. Për certifikimin e kandidatëve të cilët janë të dënuar për vepra penale në periudhën prej 3 vitesh. Lidhur me këto rekomandimet që i kemi para vetës, unë nuk i kamë listat e subjekteve politike. Iu është kërkuar subjekteve që ta bëjnë ri renditjen. Dëshiroj të di se a respektohet ligji për zgjedhjet që parashihet që çdo i 3 të jetë i gjinisë së gruas në këtë rast? A është respektua në këto listat të cilat nuk i kanë bë ri renditjen e këtyre? Dëshiroj ta di këtë si informacion. Tjetra dëshiroj të potencojë faktin që si standard, janë standarde të dyfishta në raport me subjektet që janë certifikua gjatë javës së kaluar. Ne kemi subjekte të komuniteteve të cilat realisht kanë kandiduar me më pak kandidatë, dikun 30, 40, 50 kandidatë, të cilët janë të renditur nga numri 1 deri në numrin 50 apo deri në numrin 40-të. Asnjëri nga këto subjekte politike nuk e ka pasur mundësin, që të zgjedh një numër tjetër, qoftë një numër që ata e konsiderojnë që mundë të ju sjell fat. Një datë simbolike të tyre, një numër simbolik, qoftë data të lindjes apo çfarëdo qoftë ajo. Pra secili prej atyre subjekteve ka listuar, ka renditur kandidatët e tyre nga numri 1 deri në numrin të cilin e kanë pas të përgjithshëm si total.

Pra, nuk ka pasur mundësi të lëviz nga 1 te 100 te 50, te 110. Drejtor kjo nuk është qështje që ju ka taku juve se unë e di që është bërë një kompromis lidhur me këto lista , me këto që po propozohen sot, po rekomandohen për miratim këtu, mirëpo e shoh si jo ligjore përderisa nuk respektohet ligji për zgjedhjet sa i përket kuotës. Tjetra sa i përket rekomandimit për hapësirat në broshurat e kandidatëve dhe në formularin e rezultateve të kandidatëve të hijezohen apo të s'njëzohen, kjo mendoj është qështje që i takon këshillit për operacione zgjedhore, i takon departamentit për operacione zgjedhore të cilët do ta rekomandojnë aty, do ta trajtojnë në KOZ. Nuk i takon zyrës së regjistrimit të partive politike, si qështje për të përcaktu në këtë rast broshurat edhe FRP-të. Tjetra duhet të kemi parasysh në qoftëse ne sot e miratojmë këtë propozim, këtë rekomandim që kemi, pra jo të rirenditur nga numri 1 deri në numrin të cilin e ka ai subjekt politik për kandidatë. Besoj që vërtet do ta kemi një ditë të zgjedhjeve mjaftë të vështirë, të menaxhueshme sidomos pas mbylljes së vendotimeve. Pas mbylljes së vendotimeve, nëpër secilën klasë, në secilin këshill të vendotimit do të ketë probleme në numërimin e votave të kandidatëve. Për shkak të këtyre hapësirave, boshllëqeve që po lihen, janë një listë se si do të duket dhe si do të ketë probleme është e një subjekti politik. Si do të duket kjo, pra me mungesa, pra disa numra do të jenë, disa nuk do të jenë. Do të ketë probleme në mes komisionarëve në vendotime të secilit subjekti politik. Shikoni një listë se si ka më pak kandidatë, se si është renditur nga numri 1 deri tek numri 12-të. Nuk shoh askund këtu që dikun mungon numri 2, dikush ka kapërcy e ka marr numrin 50-të apo numrin 100. Si të tillë, nuk e mbështes për arsyet që edhe të shpenzimeve që do të krijohen. Ju e dini se për një gabim, për një lëshim që është bërë për formularin e rezultateve në vitin 2019-të kemi pas shpenzime si KQZ. Për veç këtyre shpenzimeve që janë bërë nga KQZ, kemi pasur një afat të tej zgjatur, të ditës së certifikimit të rezultateve, pra është procesi më i gjatë që ka ndodh i numërimit në vitin 2019-të me rreth 90 ditë , 91 ditë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve e deri në ditën e certifikimit të rezultateve. Andaj nuk dëshiroj që edhe në këto zgjedhje të shkojmë në formë të tillë, të zgjatet edhe procesi i votave në QNR, të zgjatet edhe të ketë përplasje edhe në klasat e vendotimeve, dhe në anën tjetër të shkelet edhe ligji që përcakton qartazi se subjektet duhet të këna çdo të tretin kandidatë të gjinisë tjetër. Dëshiroj të di në qoftë se është respektua ky kriter, ky parim në këto lista që janë të propozuara. Faleminderit.

**Yll Buleshkaj:** Faleminderit shumë për pyetjen. Ne, jemi pak, i kemi duart e lidhura sepse vendimet e institucioneve si ai i PZAP, si ai i Gjykatës Supreme e ka ndalu zëvendësimin, ndërsa respektimi i kodit gjinor do të ishte i pa mundur në qoftë, se e kemi të parandaluar zëvendësimin e kandidatëve të gjinisë nën përfaqësuar. Ka subjekte politike të cilat e kanë këtë problem por ky nuk është që mundet zyra me zgjedh apo as KQZ-ja. Pse kemi vendim të qartë të dy institucioneve që kanë thënë ndalohet zëvendësimi. Thotë radhitja është e pamundur, që radhitja apo riradhitja e re për disa subjekte politike të bëhet duke

plotësuar kuotën gjinore sepse kjo është ndalu nga dikush tjetër. Kjo që na ka ndodhur ne, kësaj radhe është një gjendje e re, kjo nuk është që ka pas ndonjëherë më përpara ndonjë gjendje të tillë, ku gjykata të ndryshme e kanë, apo edhe PZAP e kanë largu disa kandidatë nga lista. E në këtë rast nuk është si në fillim kur kanë aplikua sepse në atë kohë zyra është siguru, edhe ka garantu që çdo secilën tereshe të kandidatëve të ketë nga një përfaqësues nga gjinia tjetër që është nen përfaqësuar në këtë rast. Ndërsa me kalimin e këtyre vendimeve në instanca të tjera atëherë zëvendësimi i tyre sidomos kur është ndalu zëvendësimi edhe pse neni i caktuar duket 27 i ligjit për zgjedhje të përgjithshme e cek që në qoftë se rrezikohet lista atëherë do të duhej të lejohet zëvendësimi, por këto instanca kanë vendos kështu, kështu që nuk kemi ndonjë mundësi që ta ndërrojmë. Teknikisht kjo është zgjidhja e cila është me lehta për tu bërë, nuk është organizimi i listave, shfaqë probleme tjera besoj por nuk është as teknikisht e pa realizuar, në qoftë se tash nga sot sepse askush nuk është trajtuar ende se si të numërojnë ditën e zgjedhjeve. Në qoftë se ceket shumë qartë, se si të punohet në këto raste atëherë nuk do të ketë ndonjë problem të madh. Sidomos kur e kemi këtu të shkruar që duhet ngjyra e këtyre kandidatëve që nuk ekzistojnë të jetë e shënuar me ngjyrë tjetër, që të tërhiqet vërejtja që aty të mos shënohen gabimisht votat për të shkaktuar ndonjë bartje të pa, që nuk është dashur e votave. Kemi rastin edhe me formularë të ndryshëm, kemi formular të rezultateve i cili përmban të dhënat edhe për fletëvotimet e dyfishta e ajo ngjyra e kundërt me të tjerat, i a tërheq vërejtjen të gjithë atyre që i plotësojnë që në këtë rast nuk ka nevojë futesh votat këtu sepse kjo është dikun tjetër. Edhe ky rast nuk besoj që teknikisht do të ketë ndonjë problem, por sidomos në qoftë se e cekim mirë, dhe qartë në trajnimet të cilat do të mbahen, e të cilat ende nuk kanë filluar. Faleminderit shumë.

**Arianit Elshani:** Neni 27 lidhur me kuotën gjinore thotë kështu, 27.1 në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik se paku 30% janë meshkuj dhe së paku 30% janë femra. Me nga një kandidatë të secilit gjini përfshire se paku një herë në secilin grup. Prej 3 kandidatëve që numërohen nga kandidati i parë në listë, kështu siç i kanë propozuar subjektet politike listat. A respektohet ky parim i ligjit, neni 27.1?

**Yll Buleshkaj:** Thash edhe në fillim, siç janë propozuar nga subjektet politike në fillim e kanë pas secilin, e kanë respektuar secilën nga ato, e disa e kanë tejkalluar këtë kërkesë prej 1 në 3.

**Arianit Elshani:** Tash a respektohet aktualisht kështu siç e kanë propozuar? Po them prapë sepse kjo është e subjekteve politike, nuk është çështje e juaj si drejtor.

**Yll Buleshkaj:** Shpresoj që kjo ja u ka pamundësua edhe atyre që e kishin zëvendësuar me të tjerët sepse ju ka hek kandidatët e gjinisë tjetër, e nuk mundësh me i klonu.

**Arianit Elshani:** Mujmë me bo rirenditje, nuk po kërkoj zëvendësimin, po kërkojë ri renditjen që të respektohet ligji për zgjedhjet e përgjithshme, neni 27.1.

**Alim Rama:** Faleminderit kryesuese. Unë deshta një herë me e paraqit, se kjo është tendenca me e kriju hutit e votuesit ato që përmend zotëri Elshani dihet qartë edhe në trajnimin edhe në manualin që e kemi aprovu para një jave, çka d.m.th vota e vlefshme. Vota e vlefshme është e cila votë ku dihet intenca e votuesit, edhe na e dim edhe diqka tjetër është e qartë që votat për kandidatët janë opcionale. Edhe na si subjekte, në rastin konkret si LVV na qëndrojna pas listës së dorëzuar nga LVV. Sa për sqarim, lista jonë i sqaron kushtet ligjore por ajo nuk është gjendja këtu. Por na e rezervojna të drejtën këtu për të vazhduar betejat më tutje. Kështu që, çdo ndryshim edhe çdo intervenim për me proletarizua këtë çështje është tendencioz edhe vetëm është me qëllim të krijimit të hutimit të votuesit. Na jemi pajtuar paraprakisht, që qysh i ka paraqit drejtori i zyrës rekomandimin, kështu që ajo parti që ska nevoj me ndërru, ajo na takon neve. Në qoftë se ka ma shumë se 5 ose 6 ose sado që të jetë në rregullore të KQZ-së. Se vota për kandidatët është opcionale edhe secila votë i shkon për kandidatin edhe ajo vetëm edhe vetëm dikun në radhitjen. Nuk përcakton kurgjo tjetër, kështu që une po shoh këtë debat shumë tendencioz edhe të pa nevojshëm në këtë moment. Faleminderit.

**Eshref Vishi:** Faleminderit. Unë dua të ndërlihdhëm me atë që diskutoj kolegu paraprakisht. Ne e dimë të gjithë se subjektet politike me rastin e aplikimit për certifikim të partive dhe subjekteve politike i kandidatëve i radhisin, kandidatët e tyre në listë dhe mbi këtë bazë ende pa filluar procesi i certifikimit në një far forme të gjitha subjektet politike fillojnë kërkimin e votës në para fushatë. Tani na kemi një situatë të re e cila me vendimet e PZAP-it dhe në akt vendimet e gjykatës supreme janë hjek një numër i konsiderueshme i kandidatëve nëpër listat zgjedhore. Në komunikimin që ka be zyra për regjistrimin e partive politike për mundësin e ri radhitjes së kandidatëve, ato kanë shpreh qëndrimet e tyre se nuk dëshirojnë ti radhisin numrat apo kandidatët brenda listës. Kështu që na duhet ta respektojmë vullnetin e subjekteve politike dhe kjo është krejt, në rregull. Unë mendoj se nuk duhet të krijohet huti, këto situata edhe pse janë sfiduese, janë të reja për KQZ-në. Janë të menaxhueshme në aspektin teknik, dhe nuk duhet ti preu dikojmë situatat hipotetike se çka mund të ndodh nesër. Konsideroj se administrata e Komisionit Qendror ka përvojë në administrimin dhe organizimin e këtij procesi dhe ne jemi këtu për çdo situatë, të krijojmë zgjidhje aty për aty, në qoftë se paraqiten probleme.

**Sami Kurteshi:** Faleminderit kryesuese. Ne po diskutojmë rreth listave, subjektet politike i kanë dorëzua listat e veta edhe të gjitha kanë marr përgjegjësi për listat e veta edhe marrin përgjegjësin sikurse që ka marr LVV. LVV ka vendos, përmes organit ma të lartë të këshillit të përgjithshëm për mos me ndryshua,



radhitjen në listë edhe çfarëdo tendence tjetër është d.m.th e kundërligjshme. Ne nuk e kemi ndryshua edhe nuk e kemi ndërmend me ndryshua edhe nuk e kemi ndërmend me ndal betejën juridike në lidhje me këtë çështje. Kjo ka marr fund. A ka tendenca për manipulim apo ajo është mandej një çështje tjetër edhe e organeve që janë kompetente për të duke përfshirë edhe prokurorin. E dyta, një pyetje që e kam unë, për drejtorin e zyrës për regjistrim të partive politike. Para kësaj po e bëjë edhe një çështje. Mu më vjen mirë që këto instancat juridike e kanë respektua një parim kushtetues edhe ai parimi kushtetues është se çdo person që i mbush 18 vjet ditën e zgjedhjeve ka drejtë të zgjidhet dhe të zgjedh. Këtë e kemi propozua me kohë, nuk është pranua nga KQZ-ja , edhe po më vjen mirë që e kanë rrezua këto instanca. Po kjo është një çështje tjetër. Një pyetje konkrete kamë, a janë vërtetu nga këto instancat PZAP-ja, Gjykata Supreme rastet të mos përputhjes se të dhënave në listat sepse ju keni konsiderua se ka pa saktësi edhe mos përputhje. A ka gjete raste të tilla ndonjë nga këto instanca si Gjykata Supreme apo PZAP-ja?

**Yll Buleshkaj:** Pa saktësi, me sa e di unë ata nuk janë marr me këtë punë. Ata e kanë marr si të mirë qenë, listat të cilat janë dërgua, në qoftë se nga KQZ , qoftë ato që janë dorëzua përmes imellës nga institucionet tjera. Atë që e kanë vërtetu, e kanë vërtetu që ka pas pa saktësi në llogaritje, ta zëmë që ajo ka qenë një nga arsyet që i kemi ngrit, në qoftë se i lexojmë vendimet i kanë jep disa nga shpjegimet, nuk isha shku shume në interpretimet që i kanë jep sepse janë të institucioneve tjera edhe ne nuk kemi qare, vetëm pa i zbatua. Ajo çka mendoj që është vërtetu, është që ka qenë mirë që me përfundua ashtu siç është rekomandua sepse edhe shkelja e të drejtës, qoftë të një kandidati për të qenë në listë, qoftë ajo për afatit, apo ndonjë arsye tjetër kishte me qenë si shkelje e drejtës ndaj gjithë kështu që nuk kisha jep shumë komente andej. Por, sa e di unë, ashtu sa i kem lexu vendimet nuk janë marr me këto konstatime me verifikim të saktësisë, por i kanë marr si të dhëna të mirëqena ashtu si janë dërguar.

**Alim Rama:** A janë prej 47 kandidatëve? A janë kthye tash? A janë 47 të përjashtuar. A ka me pak..?

**Yll Buleshkaj:** Janw mw pak...24..

**Ibrahim Selmanaj:** Kryetare faleminderit. Pe kalojmë një episod, jo krejt të lehtë edhe jemi para certifikimit të subjekteve politike. Unë flas për AAK se në listë na mungojnë 3 nga kandidatët të mundshëm për deputet. Këtë rast lista jonë është e dëmtuar sepse ka 3 emra që nuk figurojnë edhe janë të përjashtuar apo të larguar. Do të ishte më lehtë për neve sikurse të pranoheshin emra të rijnë, ngase vendimet e gjykatës kanë nxjerr një rezultat dhe konsideroj si qëllim të keq hapjen e një debatit tash, sepse ne e kemi edhe një marrëveshje me elegancë sot që të votohen listat dhe duhet ta bëjmë kompromisin ma të lehtë dhe dhimbshëm. Sa është i dhimbshëm dhe konsideroj se duhet të ecim

procedura sikur edhe se e kemi filluar. Besoj se debati nuk kontribuon për të mirë, d.m.th jemi në një situatë ku duhet të shohim vetëm përpara. Kështu kisha thanë ta ndalim debatin, të vazhdojmë me listat tona, secili e ka listën e vet me ato që janë certifikua nuk jemi ka i diskutojmë, i kemi para vetës situatën e re edhe mos të hapim debat koti.

**Sami Hamiti:** Është e vërtet që aktgjykimi i gjykatës supreme nuk e lejon zëvendëson edhe kushtet për çka ka konstatua gjykata thotë sepse mund të hymë në një cikël tjetër të konstatimit që mund të shtyhet data e zgjedhjeve edhe mbahet d.m.th aspekti i gjykatës supreme ka shkuar atje që ka thanë, nuk mund të ketë zëvendësime sepse shkon tutje dhe mund të shtyhet procesi. Ne e kemi biseduar më herët në çështje formale, e kemi bisedua për çështjen e listës qysh do të jetë. Është e vërtet që normativ në ligj nuk ka, kur kemi kësi lloj situata, jemi në një situatë të re. A mund të ri renditen? Për të ri renditur do të ishte më së miri, për procesin zgjedhor. Unë e kuptoj atë punë. Sepse jemi në një situatë parën, po duhet që sekretariati të punojë shumë me informimin publik tash me trupat zgjedhore sepse ato që tha Arianiti sigurisht që do të ketë probleme në vendvotime. Do të ketë dhe duhet të punohet shumë me ta dhe të ju shpjegohet gjatë trajnimit që vendet e zbarëta duhet të shikohen sepse e kemi një situatë të re. Përndryshe ju thatë që gjykata kanë bo diçka, janë kanë 47 e jonë veç 24, jo jo subjektet i kanë ndërruar vetë ata që janë kanë. Krejt janë këtu 3 edhe 2 që po dalin, tash 5 edhe ato me afatin të cilin. Ju zyra e keni qit nga 7-shi, e gjykata e ka vendos 14. Asnjë nuk ka ndryshua. Ata shumë pak që e thatë, partitë politike si subjekti, janë edhe disa subjekte i kanë ndërrua me kohë, nuk i kanë prit me ndërrua gjykata. Përndryshe asnjë vendim atje përveç datave që i kemi vendos na. A do të merret data e shpalljes së zgjedhjeve a ditës së votimit?

Atë hezitim që e tha Alimi e kemi pas edhe atë ditë, tash cila do të jetë, a konsiderohet certifikimi, ka qenë çështje e bisedës. Gjykata ka vendos që është 14 dhe është në rregull. Po është marr vendim por, kërkesa jonë e zyrës ka qenë që është me 7, dhe ai regjistër që ka ardh nga gjykata, nga këshilli gjyqësor është i plotë. Subjektet i kanë ndërruar një pjesë, pjesën tjetër veç e kanë rivendos gjykatat. Kështu që, po them për hir të procesit zgjedhor, konsideroj që do të ishte më e mira të ri renditet. Subjektet nuk kanë vendos me i ri rendit dhe një normativ ligjore nuk ekziston që na obligojë që ti ri rendisim. Uroj që sekretariati tutje veç të punojë me informim publik sepse është e vërtet që ka me pas probleme dhe ato tash në këshillin e operacioneve zgjedhore, se mirë tha Arianiti atje do të merret vendimi, qysh do të duket formulari dhe qysh do të jetë më e lehta për votuesit por, sigurisht që do të punojmë tutje. Kjo është, subjektet politike e kanë vendos me lanë të zbarëta, të hijezohen. Mendoj që gjithqysh kishte qenë më mirë me u rendit, por se kanë bë.

**Arianit Elshani:** Sigurisht edhe PZAP-i edhe Gjykata Supreme ju kanë referua aktgjykimit të gjykatës kushtetuese dhe ligjit për zgjedhjet e përgjithshme me vendimin e tyre, edhe unë po i referohem me këtë rekomandim, po i referohem ligjit për zgjedhjet e përgjithshme. Neni 27 përcakton qartë që duhet të jenë në forma grupore nga 3, kjo obligon edhe ri renditjen e listës. Një shembull, prej një subjekti politik, ku janë largu kandidatët, kemi 5 burra rresht në listë të kandidatëve. Që bie në kundërshtim me nenin 27.1 pra bie në kundërshtim me ligjin për zgjedhjet e përgjithshme, te kemi parasysh. Tjetra është që çështja e broshurave, kërkojë që të largohet nga rekomandimi i sotshëm që e kem para vetës. Broshurat e kandidatëve dhe formularin e rezultateve të kandidatëve me qenes është çështje e KOZ-it dhe DOZ-it si departament pra, të largohen nga rekomandimi.

Lidhur me ri renditjen! Afati kohorw, është dhënë deri sot në ora 16:00, sot ju është dhënë afat kohor për ri renditjen e atyre listave. Një subjekt politik ka bërë ri renditjen e saj. Unë edhe një herë, nuk po them që është intencë e KQZ-së, e drejtorit por, po them që është intencë e anëtarëve që me një marrëveshje, pra me një kompromis që është arrit, të shtyjnë edhe në kundërshtim me ligjin për zgjedhjet e përgjithshme, të shtyjnë këtë listë pa ri renditje. Kërkojë që të ipet afat deri nesër, të trajtojnë edhe një herë, të konsultohen edhe me juristët e tyre, subjektet politike edhe të bëjnë ri renditjen e listës. Përveç që ka me krijua një huti të madhe te votuesit. Hutia tjetër ka me qenë tek komisionarët siç e thash edhe ma herët. Ka me qenë huti edhe te numëruesit e votave në QNR. Kështu që veç kemi me krijua probleme me këtë rekomandim kështu siç është me këto lista siç janë. Andaj, unë si të tillë nuk e mbështes këtë rekomandim deri në momentin që ri renditen dhe respektohet ligji për zgjedhjet e përgjithshme.

**Valdete Daka:** Faktikisht, aktgjykimi i gjykatës supreme praktikisht na ndalon që të ndryshojmë ose të zëvendësojmë. Edhe në lidhje me renditjen gjinore edhe me kuotën gjinore tash na dalin subjektet të cilat ndoshta nuk munden me i rendit më sepse nuk i kanë numrat tash, ashtu siç është parapa me ligj, pra ashtu siç i kanë dërgua fillimisht listat. Pra ato lista tash më edhe në qoftë se renditen ndoshta nuk munden me e përmbush përsëri kuotën. Edhe i bien që na nuk mundemi me ndërhy. Gjithsesi na e kemi tashme një rekomandim nga zyra, edhe praktikisht na nuk kemi çka me votu. Na e kemi vetëm çështjen e kryme sa i përket certifikimit, na i kemi kandidatët e certifikuar të kthyer në lista dhe nuk na bien me votu. A do ta zbatojmë vendimin e gjykatës supreme, na vetëm obligohemi me e zbatu, pra na nuk kemi çka të votojmë në atë drejtim sepse praktikisht certifikimi është kry nga një institucion tjetër jo nga ne, dhe kandidatët konsiderohen të certifikuar. I vetmi rekomandim që unë e shoh, për të cilin na duhet me votu, ajo është certifikimin apo kthimin e dy kandidatëve të pa certifikuar nga subjekti PAJ të cilët nuk kanë bërë ankesë në gjykatën supreme. Pra subjekti i tyre nuk ka bërë ankesë dhe të njëjtit edhe pse kanë qenë të

gjykuar me dënim të plotfuqishëm për shkak të zhvendosjes së datës, nga data 22 janar në datën 14 shkurt, praktikisht ju skadon ky afat prej 3 vjetëve. Dhe zyra ka rekomandua që edhe këta dy kandidatë të certifikohen, dhe të kthehen në listën e subjektit politik PAJ. Kjo është pra, një prej rekomandimeve...

**Eshref Vishi:** Kërkesa e ZRPP-së për verifikimin e kandidatëve ka qenë nga dita e shpalljes së zgjedhjes 7 janar tash gjykata ka thanë, kjo datë të zhvendoset me 14 shkurt d.m.th në ditën e zgjedhjeve. Nëse është ky afat, atëherë dy kandidatët do të hynë, jo 22-ti, jo data 22.

**Valdete Daka:** 22 janar ka qenë na qe e kemi.. PZAP-i e ka vendos datën 22 janar ndërkaq gjykata supreme ka vendos datën 14 shkurt dhe i bie që edhe këta dy kandidatë praktikisht e kanë përfundua atë verifikimin prej 3 vjetëve. Pra ky është një rekomandim i zyrës.

**Arianit Elshani:** Paragrafi i fundit nga rekomandimi të hiqet, lidhur me rekomandimin d.m.th për broshurat të kandidatëve dhe formularin e rezultateve të hiqet..

**Valdete Daka:** Çështja e broshurave, është çështje për të cilën ende nuk është diskutua dhe ende nuk janë vendos. Tek ka me u diskutua ky format. Ne qoftë se ke diçka në lidhje me këtë pikë Sami sepse, tash e kemi rekomandimin.

**Samir Kurtishi:** Edhe për mu vendimet e këshillit të përgjithshëm të LVV janë vendime të ligjshme kushtetuese që unë nuk i ndryshojë, kjo është e qartë, këtu nuk kemi çka me diskutua. Por nuk dashta me diskutua për këtë. Po dashta me diskutu për një çështje tjetër, rekomandimi është i zyrës. Na e dimë të gjithë se krejt ky diskutim këtu, kjo krejt çka është ba është kolateral e emrit Albin Kurti nuk është diçka tjetër. Po janë vendimet, është një vendim i gjykatës supreme që thotë, se akt gjykimi i gjykatës kushtetuese është i gabueshëm por, ne e pranojmë sepse është instancë ma e lartë. E tregon pafuqishme rin e vet dhe tregon d.m.th gjendjen e drejtësisë në vendin tonë.

Gjykata supreme, i ka marr disa vendime në bazë të cilave, një rekomandim e ka ndërtua zyrja për regjistrimin e partive politike edhe këtë rekomandim, përfshi edhe futjen e dy anëtarëve të PAJ-it është partia ashkallie për integrim që duhet të respektohet d.m.th edhe ky është parimi kushtetues, për këtë na mundemi edhe të mos votojmë, mundem të votojmë kundër po kishte me qenë vendim i kundërligjshëm sepse gjykata supreme e ka vërtetu këtë çështje. Po për çështje tjera unë po them edhe një herë, krejt ky është ko lateral i emrit Albin Kurti edhe është i qartë.

**Valdete Daka:** Ju lutem në qoftë se bon mos e u merr me aktgjykime, as gjykatës kushtetuese, as supreme apo secilën qoftë gjykatë sepse nuk jemi na institucion që mundemi me i komentua edhe me i vlerësua.

Jo ju mundeni atje në subjekte politike të juaja, mundeni me i diskutua. Unë e qes në votim propozimin e zyrës sa i përket subjektit politik PAJ. Kush është pra që të kthehen në listë të kandidatëve, 2 kandidatët të cilët nuk janë certifikuar? Pra, kush është për? Mirë. Kush është kundër? Unë abstenoj. Faleminderit. Pra me 10 vota për, kthehen në listën e kandidatëve 2 persona të cilët i kanë krye, praktikisht verifikimin prej 3 viteve. Pra subjekti politik PAJ, e mban listën e kandidatëve të ri renditur ashtu siç e ka dorëzua. Atëherë, praktikisht nuk kemi rekomandime tjera. Rekomandimi sa i përket broshurave do të mbetet të shqyrtohet në këshillat tjera, ndërkaq subjektet politike nga zyra të informohen lidhur me gjithë këtë që u vendos. Vazhdojmë me raportin e këshillave të KQZ-së e ajo është këshilli për buxhet dhe financa.

#### **4.Raport i Këshillave të KQZ-së:**

Këshilli për Buxhet dhe Financa:

##### **1.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor financiar i KQZ-se për vitin 2020**

**Sami Hamiti:** Faleminderit kryetare. Sot në mbledhjen e këshillit për buxhet kemi shqyrtuar raportin vjetor, financiar të KQZ-së për vitin 2020. Kemi pas një debat dhe një diskutim të gjatë në analizë, është konstatua, që është raporti i përmban të gjitha kriteret ligjore sipas ligjit për menaxhimin e financave publike. Është një konstatim që mënyra edhe nga raporti i auditorit dhe rekomandimet që janë marr nga auditorë ato që janë përmbush, ka përparime edhe në kontrollin, edhe në mënyrën ma të mirë të menaxhimit të mjeteve financiare të financave në KQZ. Raporti i auditorit të brendshëm në kontrollet apo auditimet që i ka be, ka konstatua që ka përparime në pjesën e stafit jo permanent në kuptimin e regrutimit edhe të atë të vlerësimit të punës dhe asnjë pagës nuk është bë nga vitet paraprake , kur është konstatua që pagesat janë be, pa një vlerësim nga ana e udhëheqësve të departamentit. Pra ka përparime në këtë punë, dhe një konstatim i plotë që raporti vjetor i plotëson të gjitha kriteret ligjore dhe propozim nga këshilli unanimisht është që të votohet si i tillë dhe të procedohet për ministri.

**Valdete Daka:** Faleminderit. Nëse s'kemi pyetje shtesë. Kush është për rekomandimin e komisionit? Miratohet...

##### **2.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të auditmit të brendshëm për vitin 2020;**

**Sami Hamiti:** Pika tjetër është pak e komplikume. Shqyrtimi dhe miratimi i raporteve të auditimit të brendshëm është çështje që është e komunitetit të auditimit. Ne e kemi debatuar jo pse është në kompetencën tonë direkte kjo çështje, por kemi debatua sepse ndërlidheshin bashkërisht me raportin

financiar dhe punën që e ka bërë auditori. Të them të drejtën janë 4 auditime të cilat janë bërë sipas planit vjetor që e ka pas plani. Veprimet e auditorit d.m.th 4 nga to dhe 1 që e ka marrë drejtpërdrejt nga KQZ-ja. Një konstatim që auditori, ka bërë një unë shumë të mirë dhe ka ndihmuar shumë edhe sekretariatit në përmirësimin të rekomandimeve që vijnë nga zyra kombëtare e auditimit edhe nga raportet që i ka bërë vetë auditori i brendshëm. Të them të drejtën, ishin ato përmirësime që thanë këtu, edhe të rekrutimi i stafit që, edhe të mënyra e pagesave, edhe të një kontrolli më të mirë i brendshëm. Kështu që edhe për këtë pjesë, po them sepse është edhe Eshrefi këtu, po brenda për brenda ne nuk kemi votuar një raport të tillë, por kemi dhënë vlerësimet e plotë për këtë. Është çështje e komunitetit dhe auditimit të jep edhe një mendim të vetin për të. Por po themi që në plotësi i plotëson kriteret edhe plotësisht mirë e ka kryer punën e vetë.

**Valdete Daka:** Po urdhëro Eshref.

**Eshref Vishi:** Faleminderit kryetare. Unë vetëm po e përplotësoj kolegun Sami. Pra është një pasqyrë për KQZ-në për procesin e monitorimit të implementimit të rekomandimeve të cilat kanë dalë nga auditimet për vitin 2020-të. Në tërësi kemi 9 rekomandime, pjesërisht janë të implementuara 2 rekomandime, pjesërisht është 1 rekomandim edhe 6 rekomandime janë të adresuara e të cilat nuk janë në procesin ende të miratimit për shkak që ndërlidhen me procesin zgjedhor të zgjedhjeve lokale të cilat i kemi sivejt. Unë propozoj që të miratohet.

**Valdete Daka:** Faleminderit. Kush është për pra, për aprovimin e këtij raporti të brendshëm? Miratohet...

### 3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zyrtarët e KQZ-së për kompensimin e stafit për shkak të rrezikshmërisë me pandeminë COVID-19, për procesin zgjedhor 2021:

**Sami Hamiti:** Faleminderit kryetare. Sot në mbledhjen e këshillit për buxhet ka ardhur një kërkesë nga Sekretariati rreth kompensimit të stafit të KQZ-së në periudhën sa është procesi zgjedhor, për shkak të rrezikshmërisë nga COVID-19. D.m.th kërkesa ka ardhur nga sekretariati, e kemi shqyrtuar në kuptimin e asaj që është një kompensim të cilin realisht për rrezikshmëri po e kërkojnë edhe institucioneve, kanë thanë që një vlerësim nga sekretariati që janë të rrezikuar apo janë të shfaqur sepse janë të punuar me grupe edhe me staf jo permanent, grupe më të mëdha dhe gjatë verifikimit që i ekspozojnë këtij rreziku dhe kanë kërkuar një kompensim shtesë për 3 muaj, për janar, shkurt edhe mars sa është procesi zgjedhor. Dhe po them në këshillin për buxhet është votuar si i tillë, që të bëhen dhe të shqyrtohen në KQZ-së. Them për 3 muaj për shkak të situatës, në të cilën gjendet dhe rreziku të madh sepse tash janë të punuar me staf

jo permanent, situata ose në QNR, ose në pjesë ku është pak grumbull ma i madh, kemi rastet edhe dy proceset tjera që dy zyrtarë të lartë tonë.

Tash, a është drejtpërdrejt pse ka qenë proces zgjedhor, por kështu po vlerësohet nga sekretariati dhe si kërkesë e tillë që e kanë kërkuar edhe institucionet e tjera të kërkohej për stafin. Unë konsideroj që është e vërtet që stafi ka punë të madhe edhe ka përpjekje të mëdha edhe ka tash nëse punohet në 3 ndërrime po e shohim secilin prej sektorëve që po është me angazhimin, në ndërrim të parë, në ndërrim të dytë, në ndërrim të tretë, pjesa ma e madhe e tyre deri në 7,8 është e shtunë sot, nesër është e diele prapë konsideroj që nëse edhe institucionet tjera si kërkesa që i kanë, besoj që edhe ju takon...

**Valdete Daka:** Faleminderit. Kush është pra për këtë?

**Sami Kurteshi:** Nga ajo që dëgjova prej kolegut Hamiti, edhe nga ajo që kam lexu dokumentet, unë kam pa se nëse e kam kuptua drejt, por ju jeni këtu ju më përmirësoni. Që një kompensim i tillë nuk është parapa për njerëzit që punojnë në regjistrimin e aplikimeve edhe në qendrën e telefonatave, ku janë numër i madh i njerëzve në të njëjtën hapësirë. Që me gjasë, i kanë problemet shumë të mëdha edhe nuk e di a është parapa për këta edhe e dyta është parapa për anëtarët e KQZ-së. Tash, unë mendoj se anëtarët e SKQZ-së sekretariatit kanë punë të vazhdueshme edhe me persona të jashtëm edhe të shpeshta edhe me staf jo permanent. Anëtarët e KQZ-së nuk e kanë këtë problem, kanë takime shumë ma të rralla edhe unë nuk shoh arsye që anëtarët e KQZ-së të kompensohet por të sekretariatit, po të parashihen personat që vërtet tash në këtë moment munden me qenë ma të rrezikuar e ata janë që punojnë nëpër ato sallat për regjistrimin e aplikimeve edhe për telefonata. Përndryshe në këtë formë kështu, unë nuk jam për me e miratua. Faleminderit.

**Sami Hamiti:** Faleminderit zotëri Kurteshi. Është e vërtet që për momentin në plan operacional janë ato veprimet që zgjasin vetëm edhe 2 ditë. Edhe ai staf tash del edhe kthehet të trajnimi ose kthehet në stafe tjera. Tash s'mundemi saktë secilit me ja përcaktua, por po të themi në procesin e tanë zgjedhor deri në përfundim secilin nga sektorët e ka një periudhë kur është, tash s'mund e dallon secilin ditë me thanë, secili në përgjegjësi po themi kur është proces zgjedhor edhe sidomos kur është zgjedhje të jashtëzakonshme, i tërë stafi i sekretariatit është i angazhuar prej kohe edhe po themi në këto faza të rrezikut permanent ndaj COVID-it. Qysh doni e bëjmë, kjo kërkesa ka ardh nga sekretariati.

**Valdete Daka:** Atëherë kush është për këtë rekomandim? Po urdhëro.

**Alim Rama:** Na kemi fol në parim, edhe nuk kemi hy në detaje cili prej stafit, sepse kur flasim në KQZ-së flasim për të gjithë stafin edhe sekretariatin. Na nuk e kemi be ndarjen e stafit jo permanent..

**Valdete Daka:** Kush është për pra këtë propozim? Kush është kundër? Unë abstenoj. Faleminderit. Aprovohet me shumicë votash...

## **5.Këshilli për Informim Publik**

### Informatë për aktivitetet e Informimit Publik

**Artan Asllani:** Faleminderit kryetare. Këshilli për mbikëqyrje për informim publik nga data 9 janar e deri me 22 janar i kemi mbajte 3 mbledhje. Në ato mbledhje kemi shqyrtua dhe miratua disa tekste, teksti i parë që e kemi miratua ka qenë teksti për informim për periudhën e aplikimit të votuesve përmes regjistrimit për votim përmes postës, që ka zgjat prej 13 deri në 21 janar. Teksti tjetër që e kemi miratua ka qenë për periudhën e ndërrimit të qendrës së votimit. Teksti për informim për periudhën e konfirmimit dhe kundërshtimit që ka zgjatë periudha prej 25 deri me 27 janar. Teksti për informim për periudhën e regjistrimit për persona me nevoja të veçanta për votim përmes ekipeve mobile. Tekstin tjetër të cilin e kemi aprovua ka qenë teksti për, si të votohet përmes postës, si plotësohet fletëvotimi përmes postës, për me dërgua përmes postës. Teksti si të plotësohet fletëvotimi dhe dokumentet të cilët për identifikim të cilët janë valide për ditën e votimit. Teksti për mënyrën e votimit të votuesve, të infektuar me COVID dhe ata të cilët gjenden në vetë izolim. Teksti për mënyrën e votimit me masa të mbrojtjes duke e ditë që tash jemi në kohë pandemie, dhe si me i respektua të gjitha vendimet e IKSHP-së. Njoftimet që janë miratuar për periudhën e aplikimit për votues, përveç që janë shpërnda në ueb-faqe dhe në rrjete sociale të KQZ-së.

Gjithashtu, janë dërgua edhe ministrisë së punëve të jashtme, që me muajt me i shpërnda edhe ma shumë nëpër organizata, edhe nëpër rrjete sociale edhe në të gjitha format që i disponojnë ata që me muajt sa ma shumë me i njoftua njerëzit se si të votojnë përmes postës. Dhe njoftimi tjetër që është shpërnda nëpër media sociale, është për periudhën e ndërrimit të qendrave të votimit për ata personat të cilët kanë dëshirua me ndërrua qendrën e votimit dhe për ata të cilët janë kanë me nevoja të veçanta për me votua përmes ekipeve mobile. Kjo është sa i përket këshillit për informim. Faleminderit shumë.

**Valdete Daka:** Faleminderit. A ka dikush pyetje për Artanin? Nëse s'kemi ndonjë çështje tjetër, e mbyllim mbledhjen. Faleminderit...



